



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

---

**Fakulteti:** Bujqësisë dhe veterinarisë

**Departamenti:** Mbrojtje e Bimëve

**Programi:** Mbrojtje e Bimëve- Fitomedicinë

**NJOFTIM**

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se:

Ekzemplari (drafti ) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Ymer Ymeri, me titull: **“NDJESHMËRIA E KULTIVARËVE TË MJEDRËS NDAJ SËMUNDJEVE MË TË PËRHAPURA TË KËSAJ KULTURE NË RAJONIN E PODUJEVËS”** ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 03/07/2024 deri me datë 09/07/2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Dr. Arben Mehmeti, kryetar,
2. Prof. Asoc. Dr. Fadil Musa, mentor - anëtar,
3. Prof. Asoc. Dr. Vahid Avdiu, anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Ptof. Asoc. Dr. Fadil Musa, përmes e-mail adresës [fadil.musa@uni-pr.edu](mailto:fadil.musa@uni-pr.edu).

Për të pasur një informacion paraparak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji është mund të jetë një pasurim i punës tonë !

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË**  
**DEPARTAMENTI MBROJTJE E BIMËVE**



**PUNIMI I TEMËS SË DIPLOMËS PËR STUDIMET MASTER**

**NDJESHMËRIA E KULTIVARËVE TË MJEDRËS NDAJ**  
**SËMUNDJEVE MË TË PËRHAPURA TË KËSAJ KULTURE NË**  
**RAJONIN E PODUJEVËS**

Udhëheqës:

Prof. Asoc. Dr. Fadil Musa

Kandidati:

Bsc. Ymer Ymeri

Prishtinë, Korrik 2023

## ABSTRAKT

### ABSTRAKT

Mjedra (*Rubus spp.*) është një kulturë shumëvjeçare mjaft e rëndësishme pemëtare nga familja *Rosaceae*, gjinia *Rubus*, e cila ka vend të rëndësishëm ekonomik për vendin tonë (Zajmi, *et al.*, 2006). Kjo gjini ka shumë specie, më e njohura nga të cilat është *Idaeobatus*, që ka 120 forma. Nga këto forma të mjedrës janë përdorur më së shumti për seleksionim: mjedra e kuqe evropiane - *Rubus idaeus L.*, e cila rritet edhe në malet tona, mjedra e kuqe amerikane *Rubus idaeus L.*, nënforma *Strigosus*, mjedra e purpurtë *Rubus neglectus* Pack, të cilat janë përhapur në Amerikën Veriore, dhe mjedra e kuqe e Sibirit - *Rubus idaeus L.*, nënforma *mlanolasius Focle*, e cila gjendet në Sibir, në Lindjen e Largët, në Korenë Veriore dhe në Mongoli.

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte: **(i)** Hulumtimin e sëmundjeve më të përhapura në kulturën e mjedrës në komunën e Podujevës, **(ii)** Përshkrimin e ciklit të zhvillimit të sëmundjeve dhe formën e shkaktimit të dëmeve në mjeder nga patogjenët, **(iii)** Përcaktimi i ndjeshmërisë së kultivarëve të mjedrës ndaj sëmundjeve të konstatuara, **(iv)** Masat për menaxhimin e sëmundjeve të konstatuara gjatë këtyre hulumtimeve.

Për nevojat e hulumtimit të sëmundjeve të ndryshme në kulturën e mjedrës eksperimenti gjatë gjithë vegjetacionit është ngritur në rrafshin e Kosovës përkatësisht në qytetin e Podujevës me dy lokalitete, në fshatin Livadicë dhe Velikorekë gjatë vitit 2022. Gjatë hulumtimeve njëvjeçare janë përfshirë tri lloje të kultivarëve: Polka, Mapema dhe Meeker në formën kultivuese – fushë të hapur me një sipërfaqe prej 1.47 ha.

Eksperimenti gjatë gjithë kohës është realizuar sipas metodës së blloqeve të randomizuara, për secilin kultivarë me nga tri përsëritje. Në secilën përsëritje përmes metodës së rastit janë marrë deri në 10 gjethë që kanë rezultuar me simptoma të prekjes nga sëmundjet e ndryshme, duke filluar me ato të kateve të poshtme e duke shkuar më lartë. Me një interval kohorë çdo 10 ditë për secilën moster.

Mostrat e marra janë dërguar në laboratorin e mbrojtjes së bimëve në Fakultetin të Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë për mbjelljen e tyre në baza ushqyese në PDA dhe

NA (Potato Dextrose Agar dhe Nutrition Agar) për identifikimin dhe përshkrimin e llojeve të patogjeneve prezent.

Rezultatet e fituara kanë treguar prezencën e këtyre sëmundjeve: Tharrja e llastarëve të mjedrës (*Didymella applanata*), Kanceri i mjedrës (*Agrobacterium tumefaciens*) dhe Kalbëzimi i hirtë i frutave të mjedrës (*Botrytis cinerea*). Paraqitja e sëmundjeve të konstatuara ka qenë evidente që nga fillimi i vegjetacionit, me shfaqjen e simptomave në gjethet e mjedrës dhe më pas edhe në zhvillimin e infeksionit që ka zgjatur deri në fund të vegjetacionit. Niveli i paraqitjes së këtyre sëmundjeve gjatë gjithë vegjetacionit ka qenë mjaft variabil duke shkaktuar dëme të konsideueshe te kultivaret e mjedrës.

Frekuenca e paraqitjes së këtyre sëmundjeve si dhe dëmet e shkaktuara nga këta patogjenë gjithashtu kanë qenë e ndryshme në kultivaret e ndryshëm të mjedres duke i shkaktuar atyre humbje substanciale si në rendimet po ashtu edhe në cilësinë më të dobët të frutave të prodhuar te mjedres.

Intensiteti dhe shfaqja më e madhe e sëmundjeve të konstatuara ka qenë evidente sidomos në pjesën e dytë të vegjetacionit, atëherë kur medomos duhet ndërmarrë masa adekuate mbrojtëse për mbajtjen nën kontroll të tyre.

Masat e ndërmarra mbrojtëse duhet ndërmarrë në kuadër të Mbrojtjes së integruar ku përparësi duhet dhënë masave të tjera sikurse janë, mbjellja e kultivarëve tolerant, fidanët e certifikuar dhe të shëndosha, masat agroteknike dhe pomoteknike të rregullta dhe adekuate, dhe si alternative të fundit sidomos në rastet kur tejkalohet pragu kritik për sëmundje të caktuara edhe përdorimin e preparateve kimike.